

VENDIM
Nr.834, datë 10.12.2004

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.726, DATË 21.12.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjave “ç” e “dh” të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 19 ndryshohet si më poshtë vijon:

“19. Për punonjësit efektivë, kërkimorë e shkencorë, në institutet kërkimore-shkencore, paga bazë mujore është:

- Drejtues kërkimesh B2;
- Mjeshtër kërkimesh B3;
- Kërkues me gradë shkencore B5.

Kur këta punonjës caktohen në funksione drejtuese, përveç pagës përkatëse, marrin edhe shtesë mbi këtë pagë, në përqindje, si më poshtë vijon:

- Drejtor instituti
- Sekretar shkencor i seksionit në Akademinë e Shkencave 17;
- Zëvendës drejtor instituti
- Drejtor në qendrën kërkimore-shkencore 13;
- Përgjegjës departamenti 12;
- Përgjegjës qendre kërkimore-shkencore
- Përgjegjës shërbimi
- Kryetar seksioni në Akademinë e Shkencave 10;
- Përgjegjës seksioni
- Përgjegjës klinike
- Përgjegjës sektori 8.

Punonjësve, që nuk janë efektivë të shkollave të larta ose të instituteve kërkimore-shkencore, por janë bashkëpunëtorë në veprimtaritë e këtyre shkollave ose instituteve, si dhe punonjësve efektivë të shkollave të larta, që nuk janë punonjës pedagogjikë (janë nëpunës) u jepet shpërblim mujor, si më poshtë vijon:

- Profesor, drejtues kërkimesh 5600 lekë;
- Profesor i asociuar, mjeshtër kërkimesh 4900 lekë;
- Për gradën shkencore “doktor i shkencave” 4200 lekë.”.

2. Pas pikës 19 shtohet pika 19/1, me këtë përmbajtje:

“19/1. Për punonjësit efektivë, pedagogjikë-shkencorë e kërkimorë në shkollat e larta, me kohë të plotë, paga bazë mujore është:

- Profesor A 8;
- Profesor i asociuar A 11;
- Pedagog me gradë shkencore B 2.

Kur këta punonjës caktohen në funksione drejtuese, përveç pagës përkatëse, marrin edhe shtesë mbi këtë pagë, në përqindje, si më poshtë vijon:

- Rektor i universitetit të kategorisë I 25;
- Zëvendësrektor i universitetit të kategorisë I
- Rektor i universitetit të kategorisë II 20;
- Zëvendësrektor i universitetit të kategorisë II 17;
- Dekan, kancelar i universitetit të kategorisë I 15;

- Zëvendësdekan,
Kancelar në universitetin e kategorisë II 13;
- Përgjegjës departamenti 12;
- Kancelar në fakultet 10;
- Përgjegjës seksioni, përgjegjës sektori 8.”.

3. Në lidhjen I “Renditja e funksioneve sipas klasifikimit”, të bëhen këto ndryshime:

a) Në klasifikimin “A2” shtohet emërtesa “Kryetar i Akademisë së Shkencave”.

b) Paga për këtë klasifikim bëhet “150 000 lekë”.

c) Në klasifikimin “A3” shtohen emërtesat “Zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave” dhe “Sekretari shkencor i Akademisë së Shkencave”;

ç) Paga për këtë klasifikim bëhet “117 000 lekë”;

d) Në klasifikimin “A6” shtohet emërtesa “Akademik”;

dh) Në klasifikimin “B3” shtohet emërtesa “Pedagog”;

e) Në klasifikimin “B4” shtohet emërtesa “Asistent në shkollat e larta”;

ë) Në klasifikimin “A4” emërtesa “Kryetar i Akademisë së Shkencave”, shfuqizohet;

f) Në klasifikimin “A8” emërtesat “Zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave” dhe “Sekretar shkencor i Akademisë së Shkencave” shfuqizohen;

g) Në klasifikimin “B1” emërtesa “Akademik”, shfuqizohet;

gj) Në klasifikimin “C2” emërtesa “Pedagog”, shfuqizohet.

4. Lidhja II-8 “Niveli i pagës për punonjësit e Akademisë së Shkencave”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Mbi pagat e caktuara sipas këtij vendimi zbatohet indeksimi i përcaktuar në vendimin nr.184, datë 10.4.2004 të Këshillit të Ministrave “Për masën e indeksimit të pagave për vitin 2004”.

6. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga Buxheti i Shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2005.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhja II-8

Niveli i pagës për punonjësit e Akademisë së Shkencave
I.

Nr.	Emërtimi	Klasifikimi/paga
1	Kryetar i Akademisë së Shkencave	A2
2	Zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave Sekretar Shkencor i Akademisë së Shkencave	A3
3	Akademik	A6
4	Drejtues kërkimesh	B2
5	Mjeshtër kërkimesh	B3
6	Kërkues me gradë shkencore	B5
7	Kërkues	C2

II.

Nr.	Emërtimi	Klasa	Shtesë për funksion
8	Sekretar shkencor seksioni, përgjegjës sektori	X	6
9	Kryetar dege	IX	5

10	Specialist	VII-VIII	
11	Përgjegjës administrate	VI	1
12	Arkivist	VII	
13	Redaktor, përkthyes, sekretar i kryetarit	VI	
14	Përgjegjës ofiçine	V	1
15	Llogaritar i parë, ekonomist	V	
16	Shofer	II-III	
17	Arkëtar, daktilografist	III	
18	Portier, pastrues, korier	I	